

Nr. 389 Prot.

Nr. 90/23 Prot.

Tiranë 20 . 03 .2023

Tiranë 20 . 03 .2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Universiteti Barleti (UniBa) Institucion i Arsimit të Lartë, me adresë në rr. Frang Bardhi, Nr. 118, Tiranë, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Suzana Guxholli.

dhe

Banka e Bashkuar e Shqiperise sh.a. (BBSH), themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Shqiptar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër regjistrimi NUIS: J91811004Q me seli pranë adresës Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa nr. 11, Hyrja 3, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga administratori dhe Drejtori i Përgjithshëm Z. Orfea DHUCI në vijim referuar si "BBSH".

Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e secilës palë.
2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke në aplikimin e zbatimin e projekteve dhe nismave në sektorët e mëposhtëm:
 - a. Pjesëmarrje në leksione të stafit drejtues të BBSH;
 - b. Organizimi dhe mediatizimi i aktiviteteve të perbashkëta;
 - c. Pjesëmarrja në praktikat mesimore të studenteve të UMB në BBSH;
 - d. Platforma dhe forume mbi tema specifike të sektorit
 - e. Hartimi, perhapja dhe mbështetja e projektligjeve të fushave respektive
 - f. Shkembimi i praktikave të mira në aspektin manaxherial dhe qeverisës
 - g. Trajnime dhe kualifikim të stafëve respektive
 - h. Organizimi i Konferencave, Forumeve, Workshopeve dhe Seminareve
 - i. Bashkëpunimi me programe, projekte dhe nisma me fonde dhe donacione Kombëtare dhe Nderkombëtare të fushave respektive.

Neni 2

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të treja palëve në datën 20/ 03/ 2023 dhe mbetet në fuqi për 2 (dy) vite nga data e firmosjes.
2. Me përfundimin e afatit, me kërkesën me shkrim të palëve, kjo marrëveshje mund të rinovohet për një afat tjetër 2 (dy) vjeçar.





Neni 3

Informacion mbi palët

1. *Universiteti BARLETI* është një universitet privat, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni akademik elitare, bazuar në praktikën e vlerat më të mira ndërkombëtare, me programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.
2. *BBSH (Banka e Bashkuar e Shqipërisë)* u ofron klientëve të saj përvojë unike, duke i ndihmuar ata të kursejnë për të ardhmen e familjeve të tyre, të zgjerojnë bizneset e tyre ose të blejnë shtëpitë e tyre, pa cenuar bindjet e tyre, duke u përpjekur të organizojnë aktivitete bankare në linjë me vlerat etike të Islamit.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. *Universiteti BARLETI* (në vijim UniBa):
 - a. *UniBa* angazhohet në bashkëpunim me partnerët, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
 - b. *UniBa* angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në projekte, trajnime, workshope, forume, konferenca, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
 - c. *UniBa* angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut palëve në marrëveshje, duke vënë në dispozicion stafin e saj akademik në përputhje me ekspertizën e kërkuar nga projekti/ iniciativa;
 - d. Personi i kontaktit do të jetë: z./znj. me adresë e-mail: b.barushij@umb.edu.al
2. *Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH)*:
 - a. *BBSH* angazhohet të jetë partner i qëndrueshëm i palëve në marrëveshje në aplikimet e ndryshme në kuadër të programeve të Komisionit Evropian si dhe donatorëve të tjerë kombëtarë apo ndërkombëtarë;
 - b. *BBSH* do të kërkojë ekspertizë në fushën që institucioni partner mbulon, në përputhje me kërkesat dhe kriteret për një ekspertizë të caktuar;
 - c. *BBSH* do të punojë së bashku me partnerët përmes nismave të përbashkëta, duke ngritur grupe pune;
 - d. *BBSH* shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave.
 - e. Personi i kontaktit do të jetë: znj. Esli Xhani me adresë e-mail: HR@uba.com.al; esli.xhani@uba.com.al.
3. *Palët bashkarisht bien dakort si vijon*:
 - a. Të punojnë së bashku në drejtim të hartimit të projekt propozimeve në përputhje me thirrjet e donatorëve/ sektorët dhe fushat e përbashkëta të interesit;
 - b. Të jenë në kontakt për çdo thirrje të mundshme dhe mundësi bashkëpunimi në partneritet;
 - c. Të zbatojnë programet dhe projektet e përbashkëta me interes publik si dhe shkëmbimin e informacionit e dokumentacionit, i cili do të përdoret vetëm për qëllime të realizimit të projekteve;
 - d. Të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.


Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, çon detyrimisht në prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.
3. Kjo marrëveshje përmban 3 (tre) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale me të njejtën vlerë.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Universiteti Barleti
Rektor
Prof. Dr. Suzana Guxholli



Banka e Bashkuar e Shqipërisë
Drejtori i Përgjithshëm
Z. Orfea DHUCI

